



VENDIM I BORDIT TË FBK-së i DATËS 05.04.2024, Prishtinë

Bazuar në kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti i FBK-së, si dhe duke u bazuar në Nenin 31 të Rregullores së Përfaqësueseve të Kosovës, Bordi i FBK-së ka marrë vendim që të emërojë trajnerin Viktor Kovač në cilësinë e përzgjedhësit të Përfaqësueses A Femrat të Kosovës.

Viktor Kovač është trajner nga Kroacia dhe me përvojë të madhe në kampionatin kroat, ndërsa ka qenë edhe përzgjedhës i Kombëtares së Kroacisë (F), kurse së fundi ai e ka udhëhequr KBF Bashkimin në stolisjen me titullin e kampionit për edicionin 2022/23 në Superliga Femrat, si dhe triumfin në Kupë dhe Superkupë në dy edicionet e fundit.

Viktor Kovač do të udhëheq Përfaqësuesen A Femrat të Kosovës në FIBA Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla që do të organizohet në Prishtinë prej 25 deri më 30 qershor 2024.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

